

VENDIM
Nr. 185, datë 13.3.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
PUNËVE TË JASHTME, PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË
FESTIMEVE TË 100-VJETORIT TË PAVARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Shpenzime korente”, t’i shtohet fondi prej 20 291 162 (njëzet milionë e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për organizimin e veprimtarive të 100-Vjetorit të Pavarësisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha